



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Udhëzues i Planifikimit Institucional të Aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim

Për profesionistët e shëndetësisë



QENDRA KOMBETARE E EDUKIMIT NE VAZHDIM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

**UDHËZUES I PLANIFIKIMIT INSTITUCIONAL
TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM
PËR PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË**



QENDRA KOMBETARE E EDUKIMIT NE VAZHDIM

Punoi: **Ilir SHAMATA**

© Të drejtat e këtij botimi i përkasin QKEV-së
Për më shumë informacion kontaktoni:
Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim
Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr.84, Tiranë, Shqipëri.
Tel: +355 4 2452286
E-mail: info@qkev.gov.al
www.qkev.gov.al

*Ky botim është mbështetur nga projekti “Sistemi për Zhvillim
Profesional” me fondet e Agjensisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim*



LËNDA

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT	5
II. ÇFARË KUPTOJMË ME PLANIFIKIM INSTITUCIONAL TË	
AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM	7
III. VLERËSIMI I NEVOJAVE	11
IV. SI TE BËJMË NJË PLAN TË NJË AKTIVITETI TË	
EDUKIMIT NË VAZHDIM	15
V. VLERËSIMI I AKTIVITETIT	19
VI. NDËRVEPRIMI ME MJEDISIN	19
VII. MBARËVAJTJA FINANCIARE	24
ANEKSI 1	28
ANEKSI 2	31
SHTOJCË	33
PYETËSOR	35
REFERENCA	40

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT

Zhvillimet e njëpasnjëshme në sektorin e shëndetësisë lidhur me sistemin e zhvillimit profesional shtrojnë në vijimësi sfida të reja përpara institucioneve shëndetësore. Programi i ricertifikimit të njohurive të profesionistëve të shëndetësisë është një nga këto zhvillime, që ka një ndikim të madh në menaxhimin e burimeve njerëzore në fushën e shëndetësisë. Ky program¹ detajon në hapa dhe masa konkrete veprimtarinë që çdo profesionist i shëndetësisë dhe institucion shëndetësor, subjekt i këtij programi, duhet të ndër marrë në zbatim të detyrimeve që dalin nga neni 33 “Edukimi i vazhdueshëm profesional” në ligjin “Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

Në funksion dhe në zbatim të këtyre zhvillimeve ligjore përpara çdo institucioni që ofron kujdes shëndetësor, në të gjitha nivelet e këtij shërbimi, dalin detyra edhe për aktivitetet e edukimit në vazhdim për burimet njerëzore që ai disponon. Në kuptim të këtyre përgjegjësive rëndësia e planifikimit institucional të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë merr një domethënie të veçantë, pasi ky planifikim institucional bën të mundur:

- Përditësimin e njohurive dhe aftësive të personelit të institucioneve të kujdesit shëndetësor,
- Rritjen e numrit, cilësisë dhe mbarëvajtjes së aktiviteteve të edukimit në vazhdim,
- Përbush kërkesat e programit të ricertifikimit për personelin e këtyre institucioneve.

1.Shiko “Dokumentin Rregullator për ricertifikimin e Profesionistëve të Shëndetësisë” botim i QKEV

Ky udhëzues u adresohet stafëve menaxhues të: qendrave shëndetësore të kujdesit shëndetësor parësor, spitaleve të rretheve, spitaleve rajonale, qendrës universitare spitalore “Nënë Tereza”, qendrave të tjera spitalore universitare, institucioneve të shëndetit publik, drejtorive rajonale të shëndetit publik, institucioneve shëndetësore private apo publike, që operojnë në fushën e shëndetësisë apo çdo institucioni tjetër që mund të përfshihet në zhvillimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim.

Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim për profesionistët e shëndetësisë ka përgatitur këtë Udhëzues të Planifikimit Institucional të Aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim për t’u ardhur në ndihmë menaxherëve të institucioneve shëndetësore në punën e tyre për planifikimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për stafet e profesionistëve që ata drejtojnë, duke rritur rolin dhe ndikimin që vetë institucionet shëndetësore kanë në këtë drejtim. Në vijim jepen, në mënyrë të njëpasnjëshme dhe të detajuar hapat që duhen ndërmarrë për të bërë të mundur këtë proces dhe shpjegimet përkatëse.

II. ÇFARË KUPTOJMË ME PLANIFIKIM INSTITUCIONAL TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM

Planifikimi institucional i aktiviteteve të edukimit në vazhdim mund të përkufizohet si harmonizimi i të gjitha atyre veprimeve që çojnë në konceptimin, strukturimin, financimin dhe realizimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë. Institucionet që ofrojnë kujdes shëndetësor të niveleve të ndryshme mund të luajnë një rol aktiv në drejtim të promovimit dhe ofrimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim të llojeve të ndryshme për stafet e tyre të profesionistëve. Në këtë mënyrë ato bëjnë një lidhje më të mirë midis nevojave reale për njohuri dhe aftësi të përditësuara profesionale dhe aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë.

Në planifikimin e një aktiviteti të edukimit në vazhdim planifikuesi i mirë duhet të marrë në konsideratë interesat e pesë grupeve të ndryshme: *pjesëmarrësve në aktivitet, institucionit shëndetësor, lektorëve, planifikuesve dhe pacientëve.*

Situata drejt së cilës synohet është ajo e një sistemi shëndetësor që merr gjithmonë e më shumë në konsideratë nevojat për zhvillim profesional të personalizuar për çdo profesionist, duke planifikuar një pjesëmarrje të individualizuar në sistemin e edukimit në vazhdim. Në këtë koncept nevojat për trajnim të profesionistit përcaktohen nga të dhënat e regjistrit të tij të vizitave, nga trajnimet në të cilat ka marrë pjesë dhe plotësimi i këtyre nevojave, dhe që në fund të fundit reflektohen në përmirësimin e të dhënave të ushtrimit të praktikës së tij profesionale të regjistruara në bazën e të dhënave të institucionit shëndetësor.

Pra, sfida do të jetë kalimi nga një numërim i thjeshtë i krediteve të marra, numrit të orëve të trajnimit apo numrit të pjesëmarrësve që kanë ndjekur këto aktivitete, në aktivitete dhe kredite që synojnë t'i shtojnë vlerë praktikës së profesionistëve të shëndetësisë edhe brenda institucioneve ku ata ofrojnë kujdes shëndetësor.


Një menaxher i një institucioni shëndetësor në funksion të përmbushjes së nevojave të stafit të tij për zhvillim profesional ka disa mundësi për të planifikuar aktivitete të edukimit në vazhdim, siç paraqitet më poshtë:

2.1 Të kontraktojë ofrues të aktiviteteve të edukimit në vazhdim në varësi të nevojave për trajnim të stafit. Në një rast të tillë menaxheri i institucionit shëndetësor kontakton me ofrues të ndryshëm të aktiviteteve të kujdesit shëndetësor (privat apo publik) dhe më pas përzgjedh një prej tyre, i cili kontraktohet për të planifikuar dhe organizuar aktivitetin trajnues sipas nevojave të stafit të institucionit përkatës. Në këtë përzgjedhje do të vlerësohen aftësia, kompetencat profesionale dhe pedagogjike të ofruesit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim, disponibiliteti i tij dhe komponenti financiar i shërbimit të ofruar.

2.2 Të informojë anëtarët e stafit të institucionit që ai/ajo drejton lidhur me aktivitete të ndryshme të edukimit në vazhdim që janë të planifikuara nga ofrues të ndryshëm. Një informacion lidhur me këto aktivitete ai mund ta gjejë në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim dhe/ose në faqet e internetit të shoqatave/urdrave mjekësore profesionale, apo ofruesve të ndryshëm të këtyre aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Në një rast të tillë menaxheri duhet të lehtësojë dhe koordinojë pjesëmarrjen në këto aktivitete të stafit që ai drejton, për të bërë të mundur që të ketë një lidhje sa më të drejtë me shpërndarjen e pjesëmarrjes së tyre bazuar në nevojat e tyre individuale për trajnim dhe performancën e tyre në punë.

2.3 Institucioni shëndetësor planifikon dhe organizon aktivitete të vetat të edukimit në vazhdim, që mund të jenë: mbledhje klinike, studime rasti, aktivitete mësimore në grupe të vogla (2-3 leksioni/prezantime të studimeve shkencore/materiale shkencore në video etj.), trajnime në punë e sipër (trajnerë brenda ose jashtë institucionit), si dhe seminare dhe konferenca mjekësore.


Në një mënyrë skematike këto mënyra të planifikimit institucional mund të paraqiten si më poshtë:



Për sa u takon stadeve, në të cilat duhet të kalojë një proces planifikimi i një aktiviteti të edukimit në vazhdim, i realizuar nga vetë institucioni shëndetësor, siç përshkruhet në pikën 2.3, ato paraqiten si më poshtë:

- vlerësimi i nevojave;
- plani i aktivitetit të edukimit në vazhdim;
- vlerësimi i aktivitetit;

- ndërveprimi me faktorë të tjerë
- marrëdhënia financiare.



Më poshtë do të bëjmë një paraqitje teorike të detajuar të të gjitha këtyre hapave të një aktiviteti të edukimit në vazhdim të planifikuar nga një institucion shëndetësor.

Gjithashtu, në Shtojcën në fund të dokumentit do të paraqitet dhe një shembull real i planifikimit të disa aktiviteteve trajnuese për stafin mjekësor në qendrën shëndetësore Nr.6 në Tiranë të organizuar nga drejtuesit e kësaj qendre.

III. VLERËSIMI I NEVOJAVE

a) Në procesin e vlerësimit të nevojave duhet të shpjegohen bazat mbi të cilat aktiviteti i edukimit në vazhdim do të konceptohet, duke vënë një theks të veçantë në atë se çfarë duhet përmirësuar në raport me situatën ekzistuese, për të bërë kalimin nga nevojat e identifikuar në aplikimin e praktikës profesionale më të mirë të mundshme.

Disa shembuj të situatave dhe pyetje të cilat duhet të orientojnë një proces të vlerësimit të nevojave janë:

- Cilat janë ato situata të kujdesit ndaj pacientit të cilat ju i gjeni të vështira për t'i menaxhuar në mënyrë të suksesshme?
- Cilat janë pengesat kryesore në ofrimin e kujdesit shëndetësor me të cilat përballet institucioni juaj?
- Cilat janë pengesat kryesore në administrim apo në punën profesionale dhe atë kërkimore me të cilat përballet kolegët në institucionin tuaj?
- Cilat fusha të praktikës suaj në institucionin ku punoni kanë nevojë të përmirësohen?
- Në cilat fusha të praktikës suaj ka diferenca të mëdha në mënyrat e trajtimit të rasteve klinike?
- Cilat raste klinike ju vënë në vështirësi, apo ju “lënë pa gjumë”?

b) Duke u bazuar në nevojat për trajnim, të cilat ju i identifikoni, reflektoni mbi shkaqet e këtyre nevojave. A vijnë ato si pasojë e nevojës për më shumë njohuri, për më shumë aftësi dhe kompetenca, apo për një nivel më të lartë të performancës në punë?

Koment 1: Njohuri do të thotë “të dish çfarë”. Çfarë informacioni të nevojshëm audienca nuk e ka? Për shembull, kjo mund të shprehet në terma të identifikimit apo të dijenisë për udhëzuesit e praktikës klinike, apo protokollet e diagnostikimit dhe trajtimit. Një shembull tjetër mund të jenë njohuritë për një teknikë të re diagnostikimi/trajtimi, një medikament/vaksinë të re, apo një pajisje të re të prodhuar në funksion të trajtimit të një gjendjeje të caktuar shëndetësore.

Koment 2: Kompetenca/aftësi do të thotë “të dish si”. Si të kombinosh njohuritë, aftësitë dhe sjelljet në një grup të caktuar? Për shembull, kjo mund të formulohet në terma të mospërputhjes së aftësive të nevojshme për të dalluar, diferencuar apo parashikuar etj.

Rezultatet e dëshiruara – Çfarë aftësish të reja apo shtesë do të doni të marrë grupi që fokuson trajnimin tuaj? Për shembull, kjo mund të ketë të bëjë me njohjen apo integrimin e aftësive diagnostikuese me teknikat e këshillimit apo komunikimit etj.

Koment 3: Performancë do të thotë “të bësh, të kryesh”. Çfarë nuk zbatohet në praktikë, apo nuk zbatohet ashtu siç duhet? Për shembull, kjo mund të trajtohet si një aftësi për të kryer disa aspekte të diagnostikimit dhe trajtimit për gjendje të ndryshme shëndetësore etj. **Rezultatet e dëshiruara** – Si do të donit që mjekët të ndryshonin praktikën e tyre profesionale? Për shembull: A doni ju që ata të përdorin një praktikë të re diagnostikimi apo trajtimi, ose të mos përdorin më një mënyrë të vjetër dhe të tejkaluar nga koha në trajtimin e një sëmundjeje?

Ka shumë mënyra të cilat ju mund t’i përdorni për të identifikuar nevojat për zhvillim profesional të profesionistëve të shëndetësisë¹. Më poshtë po listojmë disa prej tyre:

- Sugjerime/orientime nga autoritetet përkatëse përgjegjëse për cilësinë/standardet profesionale të shërbimit shëndetësor të ofruar (p.sh. Ministria e Shëndetësisë, Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim

1.Shiko: “Kuatrë rregullator për analizën e nevojave për trajnim” botim i INSTITUTI KOMBETAR I SHËNDETIT PUBLIK QUEBEC

për profesionistët e shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik, Urdhri i Mjekut/Farmacistit, Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të institucioneve shëndetësore).

- Kërkesa formale apo informale nga vetë mjekët.
- Të dhëna të vetë institucionit lidhur me përmirësimin e performancës së kujdesit shëndetësor të ofruar
- Të dhëna të vetë institucionit lidhur me përmirësimin e performancës së kujdesit shëndetësor të ofruar¹.
- Auditim/monitorim i kujdesit për pacientin, i kryer nga stafi menaxhues i institucionit shëndetësor ose nga struktura të specializuara të monitorim/vlerësimit të shërbimeve shëndetësore në Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethe dhe në Ministrinë e Shëndetësisë.
- Të dhënat e diagnozës në momentin e pranimit të pacientit/dhe në atë të daljes nga institucioni shëndetësor.
- Të dhëna nga burime të jashtme (nga pushteti lokal, raporte të organizatave të ndihmës dhe asistencës dhe organizatave jo fitimprurëse).
- Vëzhgime, si p.sh. pyetësorë ose intervista me grupe mjekësh (*shiko një shembull të një pyetësori për mjekun e familjes në Aneksin 1*).
- Udhëzues të praktikave klinike.
- Statistika të mbledhura në nivel qendror (Ministria e Shëndetësisë ose Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor apo rajonal, Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethe).
- Të dhëna të raportuara nga “Task force”, të ngritura për raste specifike.
- Problematika dhe informacione të sjella në vëmendje nga media.

1.shiko: “Dokumenti i planifikimit individual të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë” botim i QKEV

- Konsultimi dhe ballafaqimi me literaturën mjekësore bashkëkohore.
- Tematika trajnuese që kanë dalë nga vlerësimi i kryer në aktivitete të edukimit në vazhdim të kryera më parë.
- Të tjera (specifikoni).

IV. SI TE BËJMË NJË PLAN TË NJË AKTIVITETI TË EDUKIMIT NË VAZHDIM

Në hartimin e një plani për organizimin e një aktiviteti të edukimit në vazhdim, fillimisht, duhet të përcaktohet grupi i profesionistëve për të cilin ky aktivitet do të konceptohet dhe më pas vijohet me proceset, që në detaje paraqiten si më poshtë:

- a) **Përcaktimi i profesionistëve (sipas profilit/specialiteteve) të cilëve u adresohet aktiviteti trajnues.**
- b) **Vlerësimi, që këndvështrimi institucional i aktivitetit të edukimit në vazhdim të përputhet me pritshmërinë profesionale të pjesëmarrësve të aktivitetit në terma të së tashmes apo ardhmërisë së praktikës së tyre. Për shembull: Nëse keni pasur mundësinë më parë të bëni një vëzhgim të komenteve të tyre lidhur me trajnimet e organizuara nga institucioni juaj (apo ofrues të tjerë aktivitetesh të edukimit në vazhdim) shëndetësor, çfarë ju ka rezultuar prej tij?**
- c) **A ka aktorë të tjerë, mjekë ose jo, që mund të përfshihen në këtë aktivitet të edukimit në vazhdim nëpërmjet bashkëpunimit dhe kooperimit?** *Koment: Cilin nga profesionet e punonjësve socialë, infermierëve, farmacistëve, fizioterapeutëve, mund të përfshini në aktivitetin trajnues? A mendoni se mund të stoni të marrin pjesë në aktivitetin tuaj trajnues dhe organizma të tjera, si shoqata profesionale të mjekëve ose të profesionëve të tjera?*
- d) **Cilat kompetenca të mjekëve do të adresojë aktiviteti i edukimit në vazhdim?** *Shiko më poshtë:*

Kompetencat

Kujdes shëndetësor i dedikuar ndaj pacientit, i saktë, efektiv, si për trajtimin e problemeve shëndetësore të pacientëve, ashtu edhe për promovimin e një jete të shëndetëshme për ta

Njohuri mjekësore rreth shkencës bio-mjekësore, klinike dhe konjitive (p.sh. epidemiologjisë dhe sjelljeve sociale), si dhe aplikimit të këtyre njohurive në kujdesin për pacientin

Të mësuarit e bazuar në të dhënat e praktikës mjekësore dhe përmirësimi i saj, që përfshin në vetvete investigimin dhe vlerësimin e kujdesit për pacientin, gjetjen dhe hartimin e evidencave shkencore dhe përmirësimin e kujdesit për pacientin.

Aftësi në komunikim, që rezultojnë në një shkëmbim efektiv të informacionit dhe në krijimin e një klime bashkëpunimi me pacientin, familjen e tij, si dhe me kolegët.

Profesionalizmi, në manifestimin e tij si përgjegjshmëri në kryerjen e detyrimeve profesionale, përbushje të përgjegjësisë etike dhe ndjeshmëri ndaj grupeve në nevojë të popullatës.

Praktika profesionale të bazuara në sistemin shëndetësor, që manifestohen nëpërmjet veprimeve që tregojnë ndërgjegjësim dhe përgjegjshmëri në një kontekst më të gjerë, duke e parë sistemin shëndetësor si një të tërë dhe duke synuar të përdorë burimet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Kompetenca të tjera: (Shtoni nëse keni identifikuar të tjera)

- e) **Përzgjidhni lektorët për rastet e aktiviteteve në kohë reale duke u bazuar në aftësitë e tyre profesionale në raport me temat e përzgjedhura trajnuese, aftësitë pedagogjike dhe gatishmërinë e tyre për të qenë pjesë e zbatimit të këtyre aktiviteteve trajnuese, në varësi të axhendës së tyre profesionale ose private.** Përzgjedhja e lektorëve mund të bëhet nga stafet brenda institucionit të kujdesit shëndetësor që planifikon dhe organizon trajnimin ose nga lektorë potencialë që punojnë në institucione arsimore publike apo private, në qendrat spitalore universitare, në spitalet rajonale (të rretheve), në qendrat e kujdesit shëndetësor të specialiteteve etj.
- f) **Objektivat - Hartimi i disa objektivave specifike, që procesi trajnues synon të arrijë, mund t'ju ndihmojë të rafinoni dhe bëni më të saktë planin e trajnimit, si dhe të optimizoni formatet e ofrimit të informacionit.** Gjithashtu, mund t'u

komunikohet pjesëmarrësve potencialë se çfarë ata mund të presin nga pjesëmarrja në këtë aktivitet të edukimit në vazhdim. Një taktikë që mund të përdoret për hartimin e objektivave mund të jetë kompletimi i kësaj fjalie: “Nga pjesëmarrja në këtë aktivitet të edukimit në vazhdim, një pjesëmarrës do të jetë në gjendje të.....”. Përfundojeni fjalinë duke u shprehur në terma strategjikë, në terma të njohurive të reja, të teknikave dhe aftësive të reja, si dhe të rezultateve të pritshme në shëndetin e pacientëve.

g) Cilën nga këto teknika pedagogjike mund të përdorni?

- Zgjidhjen e problemeve reale (që hasen në praktikën e përditshme)
- Praktikimin e njohurive dhe strategjive të reja të trajtimit (caktohet kohë për ushtrime praktike dhe ndërveprim, si dhe për të diskutuar njohuritë / aftësitë e reja)
- Reflektimin dhe krahasimin mbi rastet e paraqitura (duke i krahasuar ato me eksperiencat personale apo ato të kolegëve)
- Pjesëmarrjen në ndërhyrjet mjekësore që realizohen për qëllime didaktike (simulime, aktrim etj.)
- Teknikat e të mësuarit me shtrirje kohore (përsëritje e disahershme e përmbajtjes gjatë trajnimit në mënyrë që të përforcojë informacionin e dhënë për pjesëmarrësit) ose mësimdhënien e përzier (formate shumëformëshe, për shembull, leksione të gërshetuara me lexime nga literatura mjekësore)

h) Formate të trajnimeve ¹

Aktivitete në kohë reale.

Me aktivitetet në kohë reale kuptojmë një trajnim të organizuar në një mjedis të përshtatshëm, brenda ose jashtë institucionit shëndetësor, për një grup prej 15-30 profesionistësh (mjekë, stomatologë apo farmacistë). Ky trajnim mund të zgjasë nga 1-8 orë dhe mund të jetë i organizuar në mënyra

1.Shiko: “Standartet e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë” botim i QKEV

të ndryshme pedagogjike, duke filluar nga prezantime të mirëfillta teorike, të pasuara nga diskutimi i përvojave individuale të profesionistëve, reflektim mbi punën e tyre, detyra dhe procedura të veçanta profesionale, diskutime mbi zbatimin në praktikë të njohurive të marra etj.

Internet – aktivitet në kohë reale.

Ndjekja e aktiviteteve trajnuese për profesionistët e shëndetësisë në internet, në faqe të specializuara, që ofrojnë këtë shërbim, duke bërë të mundur që ata të ndjekin, lexojnë dhe diskutojnë mbi prezantime teorike apo praktike që paraqiten në internet në një mjedis të përshtatur brenda ose jashtë institucionit shëndetësor.

Internet – materiale nga arkivi

Identifikimi dhe printimi i temave trajnuese të paraqitura në internet në faqe të specializuara për trajnimin e profesionistëve të shëndetësisë, si dhe shpërndarja e këtyre materialeve për stafin e institucionit shëndetësor.

Shikim apo dëgjim i CD/DVD-ve

Përzgjedhja dhe paraqitja me projektor e materialeve trajnuese në mjedise të përshtatshme për stafin e institucionit

- i) Për aktivitetin në kohë reale (live) është e rëndësishme të keni një program të aktivitetit me temat që do të referohen dhe diskutohen, ekstraktet për secilën prej tyre dhe emrat e prezantuesve respektivë.**

V. VLERËSIMI I AKTIVITETIT

Vlerësimi i një aktiviteti ndihmon në përcaktimin shkallës së ndikimit që ky aktivitet i edukimit në vazhdim do të ketë në kompetencat, kapacitetet apo performancën e profesionistëve të shëndetësisë që morën pjesë në të.

Ka disa mënyra për të përzgjedhur llojin e vlerësimit që do të përdorni, që paraqiten më poshtë:

Strategjia e Vlerësimit	Çfarë matet ?
Vlerësim standard (Angazhim për të ndryshuar, sugjerime për përmirësime të përmbytjes) – modele të këtij vlerësimi i gjeni në fund të këtij dokumenti planifikimi institucional (Shiko Aneksin 2)	Kompetencat ose Performanca
Vëzhgime pas aktivitetit (secili nga pjesëmarrësit dërgon me postë ose email vlerësimin e tij bazuar në aplikimin e njohurive apo teknikave të reja në praktikën e tij profesionale)	Kompetenca ose performanca
Simulim (simulohet praktikimi i teknikave/ aftësisve të reja të mësuara gjatë trajnimit)	Performanca
Të tjera (nëse keni)	

VI. NDËRVEPRIMI ME MJEDISIN

- a) **Ju mund të përfshini disa mënyra për të theksuar ndikimin e rezultateve të trajnimit (p.sh. materiale edukative për pacientët, që mund të paraqiten në mjediset e institucioneve shëndetësore, praktika profesionale mjekësore, apo email-e rikujtuese për pjesëmarrësit etj.).** *Shembull orientues: ... përdorni strategji për të përforcuar mesazhet e aktivitetit trajnues si shtesa të natyrshme të aktivitetit trajnues, si: (rikujtues, komente nga pacienti). Qëllimi është të përfshijë në planifikimin e aktivitetit trajnues diçka që të përforcojë apo të zgjasë në kohë efektin e trajnimit, si p.sh.: ofrimi i fletëpalosjeve për pacientin; dërgimin e email-ve me materiale shtesë pas përfundimit të aktivitetit trajnues; dërgimin e një liste me materiale të referencës; dërgimi i materialeve me citime nga pjesëmarrës në trajnim, që shprehin mënyrën se si i kanë aplikuar apo do t'i aplikojnë metodat e reja të përvetësuara gjatë trajnimit.*
- b) **Edhe kur profesionistët e shëndetësisë përpiqen të përmirësojnë kujdesin për pacientin, ka barrierë në vetë sistemin e organizimit që mund ta pengojnë zbatimin e njohurive apo praktikave të reja,** *për shembull: kufizimet burokratike, krijimi i problemeve me orarin e punës, krijimi i problemeve me rimbursimin e trajtimit të ofruar, burimet e pamjaftueshme organizative, mungesa e teknologjisë apo aksesorëve të ndryshëm ose krijimi i konfliktit me politikat institucionale. A mund të identifikoni ndonjë barrierë apo pengesë potenciale, së bashku me strategji të mundshme për adresimin e këtyre pengesave?*

Shembull orientues : ...identifikoni faktorë që janë jashtë mundësisë së kontrollit tuaj dhe që ndikojnë duke penguar në rezultatet e kujdesit ndaj pacientëve. Përfshini në kurrikulën trajnuese metoda dhe mënyra për kapërcimin e pengesave për ofrimin e kujdesit ndaj pacientit, të tipit: distanca e madhe mes pacientëve dhe qendrave shëndetësore apo spitaleve më të afërt; kufizimet për sa i takon rimbursimit të kujdesit të ofruar (ose mungesa e rimbursimit për atë lloj shërbimi); frika e pacientëve për shërbimin e ofruar, që mund të shkaktojë refuzimin e tyre ndaj këtij shërbimi; frika nga dhembja që mund të shoqërojë procedurat e kryera gjatë trajtimit etj.

Identifikimi dhe paraqitja e këtyre pengesave, si dhe mënyrave për kapërcimin e tyre mund të bëhet si më poshtë:

Pengesa të identifikuar të sistemit	Mënyra për t'i kapërcyer pengesat e identifikuar
1.	
2.	
3.	

- c) Mund të ketë pengesa në rrugën drejt aplikimit nga ana e profesionistëve të shëndetësisë të njohurive dhe aftësive të fituara në aktivitetet trajnuese, për shembull: pasiguri lidhur me hapat që duhet të ndërmarrin për të vënë në zbatim ndryshimin, apo nevoja për të bindur edhe kolegët për këtë ndryshim etj. A mund të identifikoni ndonjë pengesë potenciale për ndryshimin e profesionistëve të shëndetësisë dhe, gjithashtu, strategji të mundshme për t'i kapërcyer këto pengesa?

Shembull orientues: ...konceptoni dhe vini në zbatim në teknikat trajnuese metoda dhe mënyra për të eliminuar, shmangur apo kapërcyer pengesat që dalin përpara ndryshimit në raport me profesionistët e shëndetësisë. Koha e pamjaftueshme dhe burimet e pamjaftueshme financiare janë shpesh pengesa për ndryshime domethënëse në raport me profesionistët e shëndetësisë. Përfshini në prezantim sqarime lidhur me përfshirjen e mundshme të procedurave dhe teknikave diagnostikuese apo trajtuese në paketat e shërbimeve që rimbursohen apo do të rimbursohen nga sigurimet shëndetësore (në rastin e institucioneve shëndetësore publike apo private që operojnë në bazë të paketave të shërbimeve shëndetësore të mbuluara nga sigurimet shëndetësore publike apo private).

Identifikimi dhe paraqitja e këtyre pengesave, si dhe e mënyrave për kapërcimin e tyre mund të jepet në një tabelë:

Pengesa të identifikuara për ndryshimin e profesionistëve	Mënyra për t'i kapërcyer pengesat e identifikuara

d) Përfshirja e metodave për përmirësimin e performancës¹ në kurrikulën trajnuese të aktivitetit të edukimit në vazhdim. A mund të përfshini mënyra për adresimin e çështjeve të kujdesit dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore të ofruara për pacientin, si: shkurtimi i shpenzimeve të tepërta në ofrimin e shërbimit, rritja e cilësisë së përshkrimit, implementimi i

1. Shiko “Dokumenti i planifikimit individual të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë” botim i QKEV

praktikës më të mirë apo reduktimi i gabimeve mjekësore?

Shembull orientues: ...veproni në një mënyrë që të integroni aktivitetet e edukimit në vazhdim në procesin e përmirësimit të praktikës mjekësore. Përfshini në kurrikulën trajnuese mënyra për të: rritur sigurinë dhe cilësinë e shërbimit për pacientin; për të ulur shpenzimet e panevojshme të shërbimeve shëndetësore të ofruara; për të realizuar përshkrim më të saktë të barnave; identifikim dhe zbatim të praktikave “më të mira mjekësore”; reduktim të gabimeve mjekësore? ... merrni pjesë brenda projekteve institucionale apo të sistemit shëndetësor në tërësi në përmirësimin e cilësisë së performancës.

Një paraqitje e aspekteve të përmirësimit të performancës mund të bëhet në formën e paraqitur më poshtë:

Aspekte të përmirësimit të performancës	Përmbajtja e planifikuar
Siguria dhe cilësia e kujdesit për pacientin	
Reduktimi i shpenzimeve të panevojshme	
Përshkrimi i saktë	
Implementimi i praktikës më të mirë mjekësore	
Reduktimi i gabimeve mjekësore	
Të tjera:	

VII.MBARËVAJTJA FINANCIARE

Një nga detyrat shumë të rëndësishme në procesin e planifikimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim nga menaxheri i institucionit shëndetësor është edhe financimi i aktivitetit të edukimit në vazhdim. Burimet e financimit mund të jenë disa:

1. Buxheti i vetë institucionit shëndetësor (ku mund të parashikohen fonde për edukimin në vazhdim në financimin e institucionit shëndetësor nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor)
2. Financime nga donatorë të ndryshëm (OJF, organizata financuese publike dhe private, kompani farmaceutike)

Në këtë buxhet mund të parashikohen burime financiare vjetore për:

- i) financimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim që organizohen nga vetë institucioni,
- ii) pjesëmarrjen e profesionistëve të shëndetësisë në aktivitete trajnuese të organizuara nga ofrues të tjerë,
- iii) kontraktimin e ofruesve të tjerë (publikë ose privatë) të aktiviteteve të edukimit shëndetësor (ky kontraktim duhet të realizohet duke zbatuar rregullat e prokurimit publik në fuqi)

Është e rëndësishme që në procesin e financimit të aktivitetit të edukimit në vazhdim nga vetë institucioni shëndetësor të respektohen hapat e mëposhtëm në funksion të transparencës së procesit:

a) Identifikoni konfliktin e interesit për çdo person që ka ndikim në përmbajtjen e aktivitetit të edukimit në vazhdim.

Pyesni personat që kanë ndikim në përmbajtjen e aktivitetit (përfshi prezantuesit, moderatorët dhe planifikuesit) nëse kanë marrëdhënie të

interesi financiar me kompani që kanë si produkt të tyre shërbime apo pajisje/barna mjekësore, që lidhen direkt me temën e aktivitetit të edukimit që po organizoni. Pyetjet mund të klasifikohen si më poshtë:

1. Prisni ju të merrni të mira materiale të çdo lloji gjatë vitit aktual kalendarik nga kompania e përfshirë financiarisht në aktivitetin e edukimit në vazhdim? (Shpërblimet e ofruara nga kompani farmaceutike për prezantime të tjera apo financim studimesh apo kërkimesh shkencore konsiderohen marrëdhënie të interesit financiar. Gjithësesi, organizatat jo fitimprurëse, organizmat që ofrojnë shërbime shëndetësore direkt për pacientët, apo agjencitë dhe institucionet publike nuk konsiderohen mbështetës komercialë të aktiviteteve të edukimit në vazhdim)
2. Merrni ju qira, aksione apo të ardhura të çdo lloji nga kompani financiarisht të përfshira në aktivitetin e edukimit në vazhdim?
3. Shërbeni ju si punonjës i çfarëdo pozicioni në ndonjë nga kompanitë financiarisht të përfshira në aktivitetet e edukimit në vazhdim?

Prezantuesit dhe moderatorët. Një mënyrë për të listuar emrat dhe institucionet ku punojnë të gjithë prezantuesit/lektorët është paraqitur në mënyrë orientuese në tabelën e mëposhtme:

Emri	Institucioni ku punon	Përgjigjja e pyetjeve të konfliktit të interesit

Planifikuesit dhe çdo person tjetër që ka ndikim në përmbajtjen e temave trajnuese. Një mënyrë për të listuar emrat dhe institucionet ku punojnë të gjithë personat që merren me planifikimin e aktivitetit të edukimit në vazhdim dhe që kanë ndikim në përmbajtjen e këtij aktiviteti është paraqitur në mënyrë orientuese në tabelën e mëposhtme:

Emri	Institucioni ku punon	Përgjigjja e pyetjeve të konfliktit të interesit

b) Buxheti: Përgatitja e një buxheti paraprak, që do të zbatohet më tej, është një element shumë i rëndësishëm i planifikimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Më poshtë paraqitet një projekt-buxhet me një listë të individualizuar për çdo zë të barabartë apo më të madh se 20% e buxhetit. Të gjitha transaksionet financiare, përfshi mbështetjen financiare nga kompanitë financuese, duhet të jenë në përputhje me politikat e përcaktuara për konfliktin e interesit të Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim.

Të ardhura (të planifikuara)		Shpenzimet (të planifikuara)	
Tarifa e regjistrimit	lekë	Pagesat për lektorët	lekë
Mbështetje financiare nga organizuesi	lekë	Shpenzime transporti	lekë
Mështetje financiare të tjera (specifikoni)	lekë	Ushqimi/Kateringu	lekë
Grante komerciale – Listo kompanitë dhe shumat e kërkuara	lekë	Qiraja e sallës	lekë
	lekë	Pajisjet kompjuterike/audio/video	lekë
	lekë	Printime	lekë
	lekë	Postera	lekë
	lekë	Fax, telefon etj	lekë
Reklamat - Listo Kompanitë dhe tarifat prej tyre	lekë	Tarifa për akreditimin e aktivitetit të edukimit në vazhdim	lekë
		Pagesat për transportin e stafit, strehimin, dietat (nëse ka)	
	lekë		lekë
	lekë	Të ndryshme	lekë
Totali		Totali	

ANEKSI 1

PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E NEVOJAVE PËR TRAJNIM PËR MJEKËT E PERGJITHSHËM/ TË FAMILJES

Ky pyetësor synon të ndihmojë institucionet e kujdesit parësor në zhvillimin e programeve trajnuese për mjekët e përgjithshëm/ të familjes.

Emri:

Institucioni:.....

Qyteti/komuna:.....

1. Cilat janë shërbimet/procedurat më të zakonshme të kujdesit shëndetësor që keni kryer në 12 muajt e fundit në ambientet e praktikës suaj profesionale?

Procedurë

Detaje

1

2

3

4

5

2. Cilën nga temat e mëposhtme do të donit të ndiqnit në një aktivitet të edukimit në vazhdim?

Mjekësore

- Kujdesi për të moshuarit
- Përdorimi i drogës dhe alkolit
- Alergjitë

- Kujdesi antenatal
- Azma
- Artriti
- Sëmundjet e gjirit
- Skanim i kancerit (mamografi, kolonoskopi, PAP test, ekzaminimi rektal dixhital, PSA Testi)
- Sëmundjet kronike të veshkave
- Sëmundjet kronike të mëlçisë
- SPOK
- Sëmundjet kronike të zemrës
- Depresioni
- Dermatologjia
- Diabeti
- Herniet dhe sëmundjet perianale
- Kolesterolit i lartë në gjak
- Hipertensioni
- Imunizimi
- Menaxhimi i menopauzës
- Shëndeti mendor
- Migrena
- Neonatologjia
- Obeziteti
- Oftalmologjia
- Osteoporozë
- Pediatria
- Dermatologjia Pediatrike
- Sëmundja Inflammatorë e Pelvisit
- Shëndeti riprodhues
- Dëmtimet nga sporti
- Sëmundjet seksualisht të transmetueshme
- Urologjia
- Infeksionet e traktit urinar
- Vasektomia

Tema jo mjekësore

- Kujdesi për fëmijët
 - Kujdesi për adoleshentët
 - Afërsi komunikuese
 - Menaxhimi i rrezikut
3. Ka ndonjë temë tjetër që ju do të donit ta merrnit në konsideratë, që nuk është mbuluar nga ky pyetësor?
-
-

4. Do të dëshironit që aktiviteti trajnues të zhvillohej gjatë:

1.Paraditeve

2.Mbasditeve

3.Fundjavave

ANEKSI 2

FORMULARI I VLERËSIMIT TË AKTIVITETIT TË EDUKIMIT NË VAZHDIM

Titulli i
aktivitetit : _____

Qendra Shendetësore/Spitali _____

Data : _____

Qyteti/Komuna _____

Emri i pjesëmarrësit (fakultative) _____

Përbajtja e aktivitetit:

	Aprovoj plotësisht		Aprovoj		Nuk aprovoj
Unë dot të aplikoj njohuritë/aftësitë e marra	5	4	3	2	1
Aktiviteti plotësoi nevojat e mia për trajnim	5	4	3	2	1
Formati i aktivitetit përforcoi objektivat trajnuese të aktivitetit	5	4	3	2	1
Kontribut në përmirësimin e efektivitetit profesional	5	4	3	2	1

Objektivat e trajnimit

Mbas pjesëmarrjes në këtë aktivitet unë mund t'i :

	Aprovoj plotësisht		Aprovoj		Nuk aprovoj
1. _____	5	4	3	2	1
2. _____	5	4	3	2	1
3. _____	5	4	3	2	1
4. _____	5	4	3	2	1

Atmosfera gjatë aktivitetit

	Aprovoj plotësisht		Aprovoj		Nuk aprovoj
Mjedisi ku u zhvillua aktiviteti ndihmonte të mësuarin	5	4	3	2	1
Vendndodhja ishte e përshtatshme	5	4	3	2	1
Pajisjet audio dhe video ishin të mira	5	4	3	2	1
Aktiviteti nuk kishte ndikime të tërthorta komerciale	5	4	3	2	1
Çdo konflikt i mundshëm interesi u bë publik	5	4	3	2	1

Vlera e çdo seksioni dhe prezantuesi gjatë aktivitetit

		E vlefshme		Pranueshëm		E pakënaqshme
_____	Prezant. 1	5	4	3	2	1
_____	Prezant. 2	5	4	3	2	1
_____	Prezant. 3	5	4	3	2	1
_____	Prezant. 4	5	4	3	2	1
_____	Prezant. 5	5	4	3	2	1

Bazuar në njohuritë që morët në këtë aktivitet, ju lutem listoni dy aplikime të mundshme të këtyre njohurive/aftësive në praktikën tuaj profesionale:

Sa besim keni se do të përdorni njohuritë/aftësitë e “reja” në praktikën tuaj:

Rrethoni një shifër: 100% 75% 50% 25% 0%

Komente të përgjithshme:

SHTOJCË

SHEMBULL I PLANIFIKIMIT TË NJË AKTIVITETI TË EDUKIMIT NË VAZHDIM NGA STAFI DREJTUES I QENDRËS SHËNDETËSORE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR NR. 6 NË TIRANË

Në qendrën shëndetësore Nr. 6 në Tiranë njësia e edukimit në vazhdim e ngritur nga drejtori i qendrës, me mbështetjen e Projektit për Zhvillim Profesional, inicioi një proces të planifikimit dhe organizimit të disa aktiviteteve trajnuese për stafin mjekësor të qendrës. Në këtë qendër u përshtat një mjedis si sallë trajnimi, i cili u pajis me një kompjuter, një projektor, si dhe mobilimin e duhur për funksionimin e tij.

Procesi i planifikimit filloi me vlerësimin e nevojave për trajnim të mjekëve të qendrës. Për të kryer këtë vlerësim, fillimisht, nga sistemi i informacionit të qendrës shëndetësore u nxorën diagnozat kryesore për të cilat stafi mjekësor i qendrës kishte lëshuar receta dhe u përpilua kjo listë:

Numri i recetave për Poliklinikën 6, Tiranë për periudhën janar-maj 2010

	Recetat	Kod diagnoza	Diagnoza
1	9312	0401	Hipertension esencial
2	2272	0250	Diabetis melitus
3	1013	0493	Astma bronkiale
4	815	0600	Hipoplazia e prostatës
5	773	0272	Arteroskleroza
6	622	0413	Angor pectoral
7	621	0428	Insuficiencë kardiake

8	609	0427	Çrregullime të ritmit të zemrës
9	551	0402	Sëmundje e zemrës nga hipertensioni
10	359	0295	Psikoza skizofrenike
11	356	0365	Glaukoma
12	347	0345	Epilepsia
13	309	0466	Bronkiti, bronkioliti
14	197	0242	Tyreotoxikoza
15	190	0332	Sindrom parkinson
16	136	0491	Bronkit kronik
17	136	0412	Infarkt i vjetër i muskullit
18	128	0532	Ulcera e duodenit
19	109	0714	Artriti reumatoid
20	105	0485	Bronkopneumonia
21	100	0280	Anemi nga hekuri
22	99	0301	Çrregullime personaliteti
23	93	0599	Infeksione të uretrës e të rrugëve urinare
24	92	0296	Psikoza active
25	83	0477	Rhiniti alergjik
26	81	0174	Tumori malinj i gjirit te femrat
27	79	0715	Artoza

Në vijim, bazuar në këto të dhëna, u hartua një pyetësor (shih më poshtë) që duhej të plotësohej nga mjekët e qendrës për të vlerësuar nevojat për trajnim të perceptuara prej tyre lidhur me këto diagnoza:

Pyetësor

Vlerësimi i Nevojave për Trajnim për Mjekët e Qendrës Shëndetësore nr. 6
Njësia e Edukimit në Vazhdim, Qendra Shëndetësore nr. 6
Tiranë, më 30.06.2010

*Ju lutemi, rrumbullakosni 7 temat për të cilat ju keni më shumë
interes për trajnim*

1. Sëmundjet kardiovaskulare

Hipertensioni esencial

Arteroskleroza

Insuficienca kardiake

Çrregullime te ritmit

2. Sëmundjet neuropsikiatrike

Psikoza skizofrenike

Epilepsia

Çrregullime të personalitetit

3. Sëmundjet endokrionologjike

Diabeti melitus

Tyreotoxikoza

4. Neoplazmat

Hiperplazia e prostatës

Tumoret malinje të gjirit te femrat

5. Sëmundjet respiratore

Astma bronkiale

Bronkit, bronkiolit

Bronkit kronik

6. Të ndryshme

Artrit reumatoid

Ulçera duodenale

Infeksione të rrugëve urinare

Në vijim të plotësimit të pyetësorit dhe të përpunimit të të dhënave të tij dolën edhe temat trajnuese të përzgjedhura më dendur nga mjekët, si më poshtë:

Të dhënat nga pyetësori

Diagnoza	Numri i kerkuar
Sëmundjet kardiovaskulare	
Arteroskleroza	11
Hipertensioni esencial	4
Insuficienca kardiake	13
Çrregullime të ritmit	11
Menazhimi i urgjencave me të shpeshta kardiovaskulare	1
Sëmundjet neuropsikiatrike	
Psikoza skizofrenike	5
Epilepsia	7
Çrregullime të personalitetit	5
Autizmi	7
Sëmundjet endokrinologjike	
Diabeti melitus	21
Tyreotoxikoza	5
Sindroma metabolike	1
Obeziteti	1
Neoplazmat	
Hiperplazia e prostatës	8
Tumoret maligne të gjirit të femrat	11
Melanomat	1
CA coli uteri	2
Sëmundjet respiratore	
Astma bronkiale	16
Bronkit, bronkiolit	7
Bronkit kronik	2
Alergjite	2
Mykoplazma të fëmijët	1

Të ndryshme	
Infeksione të rrugëve urinare	4
Artit reumatoid	14
Ulcera duodenale	7
Morbus Crhon	1
Sindromi nefrotik	1
Papiloma	1
Anemia	1
Ushqyerja pediatrie	1
Glomerulonefriti Akut	2
Osteoporoza	2

10 Diagnozat më të kërkuara

	Diagnoza	Numri i kerkuar
1	Diabeti Melitus	21
2	Bronkit, Bronkiolit	17
3	Astma Bronchiale	16
4	Artriti Reumatoid	14
5	Insuficienca Kardiake	13
6	Çrregullime te Ritmit	11
7	Tumoret mailnje të gjirit te femrat	11
8	Hiperplazia e prostatës	8
9	Epilepsia	7
10	Ulcera Duodenale	7

Në vijim nga njësia e edukimit në vazhdim të qendrës shëndetësore Nr. 6 u organizua një diskutim në grup për të mbledhur mendimet e stafit mjekësor nga eksperiencia trajnuese të mëparshme në lidhje me çështje të tilla, si :

- *Dita më e përshtatshme e javës për organizimin e aktivitetit trajnues*
- *Orari dhe kohëzgjatja e aktivitetit trajnues*
- *Numri më i përshtatshëm i pjesëmarrësve*

- *Profili i trajnerëve të përfshirë në aktivitet*
- *Lloji i aktivitetit trajnues*

Në konkluzion të këtij diskutimi u përcaktuan ditët më të përshtatshme për organizimin e trajnimeve dhe kohëzgjatja e tyre.

Një moment tjetër i rëndësishëm në radhën e punës dhe për organizimin e këtyre aktiviteteve trajnuese nga njësia e edukimit në vazhdim të qendrës Nr. 6 ishte edhe përcaktimi i disa standardeve për organizimin e një aktiviteti cilësor (duke u bazuar në zhvillimin e një aktiviteti ku pjesëmarrësit ndërveprojnë me lektorët dhe me njëri-tjetrin), si dhe trajnimi i lektorëve në zbatimin e këtyre standardeve, si më poshtë:

- *Përgatitja e një kurrikule trajnimi (powerpoint ose word)*
- *Përcaktimi i materialeve që do t'u shpërndaheshin pjesëmarrësve*
- *Përgatitja e një strukture pyetjesh për diskutime lidhur me temat trajnuese*
- *Parashikimi i momenteve për diskutime në grup*
- *Përgatitja e ushtrimeve/ rasteve studimore për pjesëmarrësit (të improvizuara ose me pacientë)*
- *Përgatitja e pre dhe post testeve për pjesëmarrësit*

Në vijim u kontaktuan profesionistë specialistë në fushat respektive trajnuese me eksperiençë në ofrimin e trajnimeve dhe u përzgjedhën personat për çdo temë, vendi ku do të zhvillohej aktiviteti, datat përfundimtare dhe ora e zhvillimit të aktivitetit për çdo temë trajnuese, siç është paraqitur më poshtë:

	Temat trajnuese	Datat	Trajnuesit
1	Planifikimi individual i nevoja për trajnim dhe menaxhimi i kohës së punës për mjekun e përgjithshëm	24 shtator	Emër Mbiemër
2	Çështje kardiologjike: HTA, insuficienca kardiake, çrregullime ritmi etj	1 tetor 2010	
3	Astma dhe alergjitë	8 tetor 2010	
4	Diabeti	15 tetor 2010	
5	Mosha e tretë	22 tetor 2010	
6	Sindromi metabolik&obezitetit, dhe, risku kardiovaskular	29 tetor 2010	
7	Infeksionet respiratore te fëmijët	5 nëntor 2010	
8	Osteoporozë, artriti reumatoid, osteoartroza	12 tetor 2010	

Në funksion të garantimit të cilësisë dhe standardeve të aktivitetit të edukimit në vazhdim dhe të zbatimit të dokumenteve rregullatore në fuqi i gjithë programi i këtyre aktiviteteve kaloi në procesin e aplikimit për akreditimin e aktiviteteve trajnuese nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim.

REFERENCA:

1. The Journal of Continuing Education in the Health Professions, Volume 15, pp. 70-79;
2. MedStar Health Research Institute; <http://www.whcenter.org/body.cfm?id=1819>;
3. University of Utah School of Medicine; <http://medicine.utah.edu/>;
4. TheRoyal Australian College of General Practitioners WA Faculty; <http://www.racgp.org.au/>
5. “Dokumenti i planifikimit individual të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë”, botim i QKEV-së 2009;
6. “Standartet e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë” botim i QKEV-së 2009;
7. “Kquadri rregullator për analizën e nevojave për trajnim” botim i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, Quebec.